



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN291020240009

Tiranë, më 13.11.2024

Komisioni 150

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 828, datë: 28.12.2023, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “GENER 2” shpk, “ABA BLUE BORGO” shpk

Nr. NIPT-i: K58615301M, M41317061B

Adresa e selisë: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center 1010", Nj. A nr.2, Tiranë.

Personi përgjegjës: Artilla Ulaj, Sonila Imeraj

Për të zhvilluar projektin “**Resort Turistik ”BLUE BORGO”**.”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.

Vendndodhja: 2.2 km larg fshatit Baks-Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, Qarku Shkodër.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit: 1,471,946.0 m²

Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim: 1,471,946.0 m²

Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma): 138,678.1 m²

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë: 409,683.5 m²

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nën tokë: 145,072.0 m²

Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim: 9.42%

Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapësira publike: 16.0%

Intesiteti i Ndërtimit 0.28

Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 36.5m

Numri i kateve mbi tokë: 1, 2, 3 dhe 10

Numri i kateve nën tokë: 1

Sipërfaqja e planifikuar për gjelbërim 1,034,366.0 m²

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit).

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Referuar kërkesës së zhvilluesit “GENER 2” Sh.p.k. me nr. AN230720240004 dhe datë aplikimi 23/07/2024 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin “Resort Turistik “BLUE BORGO”, me vendndodhje Baks Rrjoll të komunës Velipojë në rrethin e Shkodrës., bazuar në pikën 3, të Kreut I, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, drejtoritë teknike të ministrisë sugjerojnë si më poshtë vijon:

Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet si më poshtë vijon:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar

të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon:

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i ndërtimit dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, rekomandohet:

- Të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të përdoren materiale të rinovueshme dhe lokale, ndërtesa të jetë ekologjikisht efçente dhe e mirë-izoluar;

- Të krijohen hapësira të gjelbra rreth objektit.

Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve: Sektori i pyjeve shprehet se:

- Për sipërfaqet me formë përdorimi pyll/kullotë duhen patur parasysh parashikimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, veçanarisht pikën 6, neni 10 dhe nenin 12, të tij dhe ligjit 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”;

- Duhet marrë mendimi i AKZM;

- Të ndjekë procedurën për heqjen nga fondi pyjor/kullosor sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi;

- Të realizojë rehabilitimin e të gjithë sipërfaqes ku do zbatohet projekti.

Sektorit i mbrojtjes së natyrës shprehet se:

- sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëj rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

Sugjerojmë marrjen e mendimit të AKZM-se dhe institucioneve të tjera lidhur me zhvillimin e projektit.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet:

Mendimi 1: Ardhur ne sistem ne datë 15.08.2024, shprehet si më poshtë vijon: Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për njoftim për VNM të thelluar të shoqërisë “Gener 2” sh.p.k me zhvillues projekti shoqërinë “Gener 2” sh.p.k, në lidhje me projektin: “Resorti turistik Blue Borgo” me vendndodhje: 2.2 km larg fshatit Baks-Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, Qarku Shkodër, me të dhënat: Nr. AN230720240004, të datës 23.07.2024, ju sqarojmë se: Referuar Planvendosjes së gjurmës së zhvillimit të parashikuar, kundrejt trupave ujqorë dhe brigjeve të tyre, dhe vlerësimit kundrejt legjislacionit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore (ligji nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe Vendimit Nr. 748, datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, rezulton se: - Gjurma e zhvillimit, intersekon me trupat ujqorë përrenjt: o përroin me Inspire Id ASIG_Hid_PrrL_57831; o përroin me Inspire Id ASIG_Hid_PrrL_57819; o përroin me Inspire Id ASIG_Hid_PrrL_57821; o përroin me Inspire Id ASIG_Hid_PrrL_57823 (sipas të dhënave në Gjeoportalin e ASIG) Në rast se zhvillimi i planifikuar, nuk parashikon ndërhyrje në territorin që sipas dokumenteve emërtohet “Zona Malore”, atëherë ai, në lidhje me këto 4 trupa ujqorë të rrjedhshëm, nuk bie ndesh me përcaktimet ligjore për menaxhimin e burimeve ujore. Ndërkohë në rast se zhvillimi parashikon ndërhyrje, atëherë duhen mbajtur në konsideratë që gjerësia e brigjeve të këtyre trupave ujqorë (nga vija tokë-ujë e përroit sipas gjurmës së tij në gjeoportalin e ASIG) është 4.7m dhe ky territor i nënshtrohet kufizimeve të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar. AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE, Njëkohësisht, referuar të dhënave në Imazhin e Hartave Bazë të ASIG rezulton se territori i zhvillimit të planifikuar (Zona Rekreative dhe Zonat me ndërtime) mbivendoset mbi zonën natyrore me ligatina. Gjithashtu, referuar portalit e-Planifikimi të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, planifikimi i parashikuar ndodhet në njësinë Njësia Strukturore: VL139.N e cila është Sistem Natyror. Ligatinat janë ekosisteme të cilat janë të lidhura me burimet ujore. Por sa i përket shpalljes së tyre si të tilla dhe kategorizimit ato janë objekt i ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 për mbrojtjen e biodiversitetit. Sa më sipër, lutem të verifikoni nëse zona në zhvillim përfshin këto ekosisteme. Nëse ato klasifikohen si të tilla, bazuar në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, ato i nënshtrohen përcaktimeve të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e burimeve ujore”, (i ndryshuar).

Mendimi 2: Ardhur ne sistem ne datë 20.09.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për njoftim për VNM të thelluar të shoqërisë “Gener 2” sh.p.k me zhvillues projekti shoqërinë “Gener 2” sh.p.k, në lidhje me projektin: “Resorti turistik Blue Borgo” me vendndodhje: 2.2 km larg fshatit Baks-Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, Qarku Shkodër, me të dhënat: Nr. AN230720240004, të datës 23.07.2024, ju sqarojmë se:

Si edhe ju kemi berë me dije në komunikimin e mëparshëm, ligatinat janë ekosisteme të lidhura me burimet ujore dhe shpallja si të tilla dhe kategorizimi i tyre është objekt i ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar.

Referuar studimit të ngarkuar nga subjekti në sistem, është e nevojshme që organet e përcaktuara sipas ligjit të sipërcituar, të vlerësojnë, nëse zonat brenda zhvillimit të projektit klasifikohen si ligatina.

Për sa më sipër, lutemi të verifikoni nëse zona në zhvillim përfshin këto ekosisteme. Nëse ato klasifikohen si të tilla, ato i nënshtrohen përcaktimeve të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e burimeve ujore”, (i ndryshuar).

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet: Pas shqyrtimit të dosjes së VNM-së paraqitur nga Subjekti zhvillues: GENER2” SH.P.K. & “ABA BLUE BORGO” për veprimtarinë “RESORTI TURISTIK BLUE BORGO” me vëndodhje në 2.2 km larg fshatit Baks- Rrjoll të Nj. Ad. Velipojë. ARM-Shkodër,Lezhë, Kukës shprehët parimisht dakord , në keto kushte sjellim në vëmendje që subjekti te marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal. Gjithashtu, sugjerojme zbatimin e masave te listuara më poshtë:

- Mbetjet inerte, të gjeneruara gjatë procesit të zbatimit të projektit (dhera), të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, në bashkëpunim me autoritetet vendore.
 - Mbetjet e tjera, të gjeneruara gjatë fazës së punimeve, të cilat duhet të asgjësohen/trajtohen dhe të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar i pajisur me Lejet/Licensat përkatëse.
 - Të mbulohen mjetet e transportit që transportojnë dherat dhe materialet e tjerë të ndërtimit dhe të pastrohen para daljes jashtë kantierit.
 - Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara".
 - Ujerat e gjeneruara gjatë fazës së ndërtimit të trajtohen sipas Ligjit Nr.111/2012 Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".
- Të bëhet lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës.
- Të mos shkarkohet asnjë lloj derdhje të mbetjeve inerte jashtë territorit të sheshit të projektit. - Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetëm brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.

Bashkia Shkodër shprehet: Në sistemin elektronik e- lejet pranë Bashkisë Shkodër është shfaqur aplikimi me nr. AN260620240008, dhe datë aplikimi 26.06.2024 me kërkesë të Zhvilluesit subjekti "GENER 2" shpk me Nipt K58615301M, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për "Resort Turistik Blu Borgo" "Gener 2" Shpk & "Alba Blue Borgo" Shpk.

Pasi u njohëm me dokumentacionin e aplikimit, për shprehje opinion, bëjmë me dije se: Zona e propozuar për zhvillimin e këtij investimi bën pjesë në Zonat me Rëndësi Kombëtare/Brezin Bregdetar të Shqipërisë të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 881 dt 14.12.2016 si pjesë e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Referuar Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Projekti gjatë fazës zhvillimit-zbatimit parashikon ndërhyrje në mjedis, për të cilat janë vlerësuar të gjitha masat e nevojshme që këto ndikime të jenë sa më të vogla. Ndërkohë që me përfundimin e projektit nuk parashikohet të ketë ndikime negative por do të ketë ndërhyrje përmirësuese, duke marrë në konsiderat ruajtjen e ekosistemeve egzistuese dhe korridoreve ekologjike si dhe rritjen e sipërfaqes së gjelbër Brenda resortit.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se:

Mendimi 1: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, lidhur me projektin: "Resorti Turistik Blue Borgo", Velipojë, Shkodër, me zhvillues dhe aplikues "GENER 2", me nr. aplikimi AN230720240004, rezulton se një pjesë e sipërfaqes dhe konkretisht pikat nr. 1 - 4, 16 dhe 17, ndodhen në zonën e mbrojtur PMT/U "Lumi Buna - Velipojë", shpallur me VKM-në Nr. 682, datë 02.11.2005 "Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur", kategoria V e zonave të mbrojtura, në nënzonën qendrore (1b) dhe pikat 5 – 15, në nënzonën e zhvillimit tradicional (2b). Sipas Vendimit nr. 10, datë 28.12.2020 të KKT "Për miratimin e kufijve të zonave të Mbrojtura", sipërfaqja ndodhet në nënzonën qendrore (ZQ) dhe një pjesë e vogël në nënzonën rekreative (ZR), të Peizazhit të Mbrojtur "Lumi Buna - Velipojë". Referojuni ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", neni 20, pika 1, 2 dhe 3, VKM-së Nr. 682, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e lumit Buna dhe territoreve ligatinore përreth tij "Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur", pika 4, shkronja A.2, Pika 4, shkronja B.1. Referuar sa më sipër cituam, zhvillimi i këtij aktiviteti bie në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura".

Mendimi 2: Bazuar në plotësimin e dokumentacionit dërguar në aplikim (koordinatat e paraqitura në Raportin Final të Studimit Mjedisor të sheshit të ndërtimit), lidhur me aktivitetin "Resorti Turistik Blue Borgo", Velipojë, Shkodër, me zhvillues dhe aplikues "GENER 2", me nr. aplikimi AN230720240004, rezulton se një pjesë e sipërfaqes dhe konkretisht pikat nr. 1 – 3 dhe 6 - 8,

ndodhen në zonën e mbrojtur PMT/U “Lumi Buna - Velipojë”, shpallur me VKMnë Nr. 682, datë 02.11.2005 “Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur”, kategoria V e zonave të mbrojtura, në nënzonën qendrore (1b) dhe pikat 4 - 5, në nënzonën buferike (2b). Sipas Vendimit nr. 10, datë 28.12.2020 të KKT “Për miratimin e kufijve të zonave të Mbrojtura”, konkretisht pikat me nr.1-3 dhe 6-8, ndodhen në nënzonën qendrore (ZQ) dhe një pjesë e vogël dhe konkretisht pikat 4 dhe 5, ndodhen në nënzonën rekreative (ZR), të Peizazhit të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë”. Referojuni Ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 20 pika 1, 2 dhe 3, neni 48 dhe neni 50, si dhe VKM-së Nr. 682, datë 02.11.2005.

Mendimi 3: Bazuar në plotësimin e dokumentacionit dërguar në aplikim (koordinatat e paraqitura në Raportin Final të Studimit Mjedisor të sheshit të ndërtimit), lidhur me aktivitetin: “Resorti Turistik Blue Borgo”, Velipojë, Shkodër, me zhvillues dhe aplikues “GENER 2”, me nr. aplikimi AN230720240004, rezulton se sipërfaqja e kërkuar ndodhet në zonën e mbrojtur PMU/T “Lumi Buna - Velipojë”, shpallur me VKM-në Nr. 593, datë 25.09.2024, “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të lumit Buna, Velipojë”. Sipërfaqja ku do të zhvillohet projekti, është inproduktive dhe një pjesë e vogël e saj është e mbuluar me bimësi barishtore. Kjo sipërfaqe, nuk klasifikohet ligatinore.

Referojuni Ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 20 pika 1, 2 dhe 3, si dhe VKM-së Nr. 593, datë 25.09.2024.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 25.10.2024. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguroa të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Nga banoret nuk pati kontestime dhe mendime kundra, gje për të cilën shprehen dakortesine për dakortesine për zhvillimin e këtij aktiviteti

3. Arsytet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 150, datë 13.11.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, me nr.4934 prot, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- AKM ka gjykuar leshimin e vendimit për VNM të Thelluar në komisionin nr. 90 date 18.07.2024.
- Në njoftim për vazhdim procedure për VNM të Thelluar në komisionin nr 126 date 01.10.2024
- Mendimin e Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Mendimin e Bashkisë Shkoder;
- Mendimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

- 4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**
- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1
- 4.3 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 4.4 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi.
- 4.5 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.**
- 4.6 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
- 4.7 Subjekti të kontaktojë me pushtetin vendor për largimin e mbetjeve inerte, që do të gjenerohen gjatë fazës së shëmbjes së objekteve ekzistuese.
- 4.8 Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
- 4.9 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.10 Te respektohet Ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 20 pika 1, 2 dhe 3, si dhe VKM-së Nr. 593, datë 25.09.2024.
- 4.11 Subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:
- 4.12 Te respektohet Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” I ndryshuar;
- 4.13 Te respektohet Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe te bej rehabilitim e zonës me mbjellje pemësh.
- 4.14 Te zbatohen parashikimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, veçanarisht pikën 6, neni 10 dhe nenin 12, të tij, si dhe ligjit 9693, date 19.3.2007 “Për fondin kullosor”,
- 4.15 Të realizohet rehabilitimi sipas fazave të projektit dhe sipërfaqeve të përdorura për të;
- 4.16 Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 4.17 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.18 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.19 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara.
- 4.20 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).

- 4.21** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.22** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.23** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.24** Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujqor dhe atë tokësor.
- 4.25** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.26** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.27** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.28** Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.
- 4.29** Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.30** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.31** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 4.32** Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 4.33** Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 4.34** Rekomandojmë përdorimin e materialeve lokale dhe të rinovueshme.
- 4.35** Ndërtesa të jetë sa më efiçente dhe e mirë-izoluar;
- 4.36** Të minimizohet ngritja e pluhurave në ajër dhe shkarkimet e gazeve të dëmshëm;
- 4.37** Krijimin e hapësirave të gjelbra rreth zonës së ndërtimit;
- 4.38** Kur është e mundur, të krijohen tarraca të gjelbra.
- 4.39** Rekomandojmë lirimimin e bregut dhe pozicionimin e hotelit më në brendësi të tokës.
- 4.40** Para funksionimit të aktivitetit, subjekti duhet të marrë masa lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose kanalizimin e tyre me rrjetin kryesorë të zonës.
- 4.41** Subjekti nuk duhet të kryej punime gjatë orarëve të qetësisë publike dhe gjatë natës.
- 4.42** Duhet të merren masa që mos të cenohet hapësira publike e plazhit.
- 4.43** Subjekti duhet të parandaloj ndërtimin në brezin e rërës/zhavorit;
- 4.44** Subjekti duhet të shfrytëzojë rrugët hyrëse ekzistuese duke shmangur hapjen e rrugëve të reja;
- 4.45** Subjekti duhet të vendosi shenja paralajmëruese rrugore dhe përgatitjen e udhëzime për drejtuesit e automjeteve, me qëllim uljen e numrit të aksidenteve;
- 4.46** Subjekti nuk duhet të kryej punime gjatë orareve të qetësisë publike, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;
- 4.47** Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;

4.48 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit.”

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	15.05.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	15.05.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	15.05.2025	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	15.05.2025	Çdo 6 muaj

PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	15.05.2025	Çdo 6 muaj
------------------	--	------------	------------

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	15.05.2025	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto

Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për Deklaratë Mjedisore për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI


MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:


Aneksi 1. Harta me Koordinatat



PLANVENDOSJA E ZONES NE ORTOFOTO SHKALLI 1:20 000



PLANVENDOSJA E ZONES NE HARTEN 1:25 000



Koordinatat e pronës sipas 3 projeksioneve hartografike

	Gauss-Kruger		KRGJSH		UTM	
	E/X	N/Y	E/X	N/Y	E/X	N/Y
1	4376061.872	4635787.164	458983.7047	4634694.327	375982.11	4633801.292
2	4377036.967	4635322.135	459963.9804	4634240.763	376956.811	4633336.451
3	4377267.02	4635582.5	460190.9475	4634503.744	377186.771	4633596.711
4	4377061.817	4635768.286	459983.6301	4634687.097	376981.651	4633782.422
5	4377130.839	4635872.913	460051.417	4634792.502	377050.645	4633887.006
6	4377143.589	4636130.896	460061.1606	4635050.572	377063.39	4634144.885
7	4377642.764	4636422.532	460556.8203	4635347.951	377562.363	4634436.403
8	4377466.807	4636769.148	460376.8684	4635692.436	377386.477	4634782.879
9	4377339.704	4636704.707	460250.5468	4635626.53	377259.426	4634718.464
10	4377170.1	4636840.294	460079.4039	4635760.109	377089.89	4634853.996
11	4377185.804	4636945.975	460093.8733	4635865.948	377105.588	4634959.634
12	4376928.823	4637138.294	459834.7136	4636055.228	376848.71	4635151.875
13	4376731.786	4637122.754	459637.9046	4636037.397	376651.753	4635136.342
14	4376599.634	4636983.734	459507.4036	4635896.871	376519.655	4634997.378
15	4376554.996	4636541.012	459467.9319	4635453.736	376475.035	4634554.835
16	4376314.822	4636258.611	459231.105	4635168.606	376234.959	4634272.548
17	4376220.057	4636318.382	459135.6666	4635227.259	376140.232	4634332.295

Aneksi 2. Harta e AKZM-se

